

---

AKTI I THEMELIMIT  
DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
**“LegaLigj” SHPK**

---

Sot, me date 20/01/2021, ne Tirane, duke vepruar me cilesine e ortakut themelues shtetasia:

Irma Gjinaj, e bija e Vullnetit, shtetase shqiptare, lindur me 01-02-1976, ne Gjirokaster, banuese ne Tirane, rruga Frozina Plaku, Pallati 22, Apartamenti 22, mbajtese e Nr. personal H65201085P, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar;

E cila, me vullnetin e saj te lire dhe te plote vendos te krijojë shoqerine Si vijon.

## **TITULLI I**

### **EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA – KOHEZGJATJA**

#### **NENI 1 - Emri i Shoqerise**

1. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria "Legaligj" Sh.p.k. ne vijim referuar si "Shoqeria".

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

#### **NENI 2 - Regjimi Juridik i Shoqerise**

2.1 Shoqeria "Legaligj" sh.p.k. eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit si dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi si dhe dispozitat e Statutit te saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 3 - Selia**

3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Rruga "Frozina Plaku", Pallati 22, Apartamenti 22, Tirane.

3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe/ose jashte vendit, ose te krijojë shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarrese.

#### **NENI 4 - Kohezgjatja**

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaku/et e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

## TITULLI II

### OBJEKTI

#### NENI 5 - Objekti

5. Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj aktivitetet e meposhtme :

1. Keshilla per ceshtje ligjore, civile, penale, administrative, tatimore e financiare;
2. Pergatitje e kerkesave te ndryshme derguar institucioneve publike apo personave te trete private;
3. Pergatitje te kerkesave ankimore kunder vendimeve gjyqesore, akteve te prokurorit, organeve te arbitrazhit apo te administrates shteterore ne pergjithesi;
4. Pergatitjen e dokumentacionit per personat juridike;
5. Perpilimin e akteve qe duhen te vertetohen perpara noterit;
6. Hartimin e kontratave apo marreveshjeve te tjera me pale private ose publike;
7. Perfaqesimin e paleve gjate proceseve civile, penale, administrative etj;
8. Perpilimin e studimeve apo dokumenteve te tjere teorike ne lidhje me fushat te ndryshme te se drejtes;
9. Ndermjetesimin e zgjidhjes se konflikteve apo mosmarreveshjeve te ndryshme;
10. Ndermjetesimin e klienteve dhe avokateve apo shoqeri avokatesh per mbulimin e ceshtjeve ligjore.
11. Ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga legjislacioni ;

Veprimtarite e renditura me lart mund te kryhen si ne menyre te drejteperdrejte ashtu dhe per llogari te te treteve dhe, ne kuader te objektit te saj, shoqeria mund te kryeje studime dhe kerkime, si dhe mund te kryeje aktivite te tjera qe vleresohen te nevojshme dhe te dobishme per permbushjen e objektit te veprimtarise.

Shoqeria mund te bashkepusoje me individe apo shoqeri te tjera duke marre/dhene, ne menyre direkte ose indirekte, kuota ne shoqeri te tjera ose sipermarrje qe kane nje objekt te ngjashem ose te lidhur me veprimtarine e saj.

## TITULLI III

## KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

### NENI 6 – Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 100.000 LEK (njqindmije leke) i ndare ne 1 (nje) kuote.

Kapitali i shoqerise do te paguhet plotesisht nga ortaku themelues si vijon:

- Znj. Irma Gjinaj, nenshkruese i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 100.000 Lek.

6.2 Pergjegjesia e Ortakeve ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga kompania eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se ortakut ne kapitalin e shoqerise.

### NENI 7 - Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortaket e mbetur ("Ortaket e mbetur") do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te mepostme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakeve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar , cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duhet te pershijne Identitetin e Bleresit ("OFERTA"), duke ftuar se pari Ortaket e mbetur te blejne aksionet e ofruara;

(b) Ortaket mbetur do te kene te drejten te blejne kuotat e ofruara perpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertes, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati prej tridhjete (30) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofruesit.

7.3 Ne rast se me shume se nje prej Ortakeve te mbetur deshirojne te blejne kuoten e ofruar, secili prej ketyre ortakeve te mbetur do te kete te drejten te bleje kuoten e ofruar perpjestimisht sipas perqindjeve qe zoterojne ne Shoqeri, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje periudhe prej tridhjete (30) ditesh nga marrja e njoftimit sipas se cilit secili prej tyre deshiron te bleje kuoten e ofruar.

7.4 Ne rast se asnje nga ortaket e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar, sipas kushteve te percaktuara ketu, brenda tridhjete diteve nga marrja e ketij njoftimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete me te njetin cmim qe i eshte ofruar ortakeve te mbetur (sipas

HGJ

kushteve te ofertes fillestare). Nese ky kusht nuk eshte permbushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjithe ortaket e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1- 7.6 , nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht me shkrim ortakeve te tjere. Te gjitha njoftimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

### **NENI 8 - Rritja e Kapitalit**

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortaket kane te drejte te nenshkrimt te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortaket refuzoje te drejten nenshkrimt, kapitali mund te nenshkruhet nga ortaket e tjeter. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

### **NENI 9 - Zvogelimi i Kapitalit**

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

### **NENI 10 - Certifikata e pjesemarrjes**

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten e nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjithe ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

## TITULLI IV

### ORGANET E SHOQERISE

#### NENI 11 - Organet e Shoqerise

11.1 Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori.

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

##### 1) Asambleja e Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendim marres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortaket e Shoqerise.

11.2 Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

11.3 Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Ortak/e, me ane te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratoret nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republiken e Shqiperise ose jashte vendit.

11.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

11.6 Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 (njetzet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

11.7 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

11.8 Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjitha Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo videokonferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjitha pjesemarrjesit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

11.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

## **NENI 12- Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

12.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 50 % (pesedhete perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30( tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

HGJ

**12.2** Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat per permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligj apo statuti.

**12.3** Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne te pakten 75% (shtatedhjete e pese perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

**12.4** Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit ose krijimin
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividendeve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividendeve;
- (d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, likuidimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likuidimin e shoqerise;
- (f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;



(g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara;

### **NENI 13 - Administratori**

**13.1** Asambleja e Pergjithshme do te caktoje nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushtron keto detyra:

(a) menaxhon shoqerine duke zbatuar politikat siç percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;

(b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;

(c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

(d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;

(e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas rastit;

(f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per punen e Shoqerise;

(g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

**13.2** Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**13.3** Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut dhe Akt Themelimi.

**13.4** Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaqesuar Shoqerine ne marredheniet me te tretet.

**13.5** Administrator i vetem i shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar, themeluesi dhe ortaku i vetem Irma Gjinaj, e bija e Vullnetit, nenshtetase shqiptare, lindur me 01-02-1976 ne Gjiroaster me Karte identiteti Nr. H65201085P, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar.

## **TITULLI V**

### **VITI FINANCIAR, DIVIDENTI**

#### **NENI 14 - Viti Financiar**

**14.1** Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

**14.2** Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 Dhjetor 2021.

#### **NENI 15 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve**

**15.1** Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividendin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;

b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

#### **15.2 Kapitalizimi i Fitimeve**

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjit 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

## **TITULLI VI**

### **SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI**

#### **NENI 16 - Prishja-Ndarja-Bashkimi**

**16.1** Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

**16.2** Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

#### **NENI 17 - Likuidimi**

**17.1** Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

**17.2** Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore i cili do te hartojte raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

Y G J

17.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

17.4 Me likuidimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

## TITULLI VII

### NDRYSHME

#### **NENI 18 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve**

Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht. Nese, nje zgjidhje miqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çeshtja do t'i referohet gjykates kompetente ne Shqiperi.

#### **NENI 19 - DISPOZITA TE FUNDIT**

Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe .

\* \* \* \* \*

#### **ORTAKU I VETEM**

**Irma Gjinaj**

